

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
Qershor 2025

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	16.05.2025	Përsëndetje Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe në përputhje me nenet e këtij ligji, i cili rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, ju drejtohem me kërkesën për të marrë informacionin e mëposhtëm: 1. Sa është gjendja në inventarë e dronëve pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile? 2. Në sa procedura prokurimi janë kontraktuar këto dronë dhe sa kanë kushtuar? 3. Cilët janë operatorët ekonomikë që kanë furnizuar Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me dronë? 4. A janë bërë teste të dronëve të kontraktuar? 5. A ka patur probleme në rrëzimin e dronëve? Nëse po, sa raste të tilla janë regjistruar? 6. Cila është zgjidhja e gjetur për dronët e rrëzuar? Do të furnizohen sërish pa pagesë nga kontraktori, apo është përgjegjësi e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për të siguruar të tjerë? Bazuar në detyrimet ligjore për transparencë dhe në të drejtën e qytetarëve për t'u informuar, presim që të na mundësoni informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana Juaj. Piranjat Show	17.06.2025	Përsëndetje Z.K, Në vijim të kërkesës suaj për informacion të datës 16 Qershor 2025, ju informojmë si më poshtë: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) është institucion publik qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile, dhe ka për mision koordinimin dhe drejtimin e veprimtarive për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, përgatitjen dhe reagimin ndaj emergjencave civile, si dhe rimëkëmbjen pas tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Qëllimi i Mbrojtjes Civile është zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe realizimi i mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, nëpërmjet forcimit të	E plote	Nuk ka

				sistemit të Mbrojtjes Civile, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve dhe të strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin. Lidhur me pyetjet tuaja ju bëj me dije se: Sa është gjendja në inventar e dronëve pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile? Aktualisht, pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile ndodhen në inventar gjithsej katër dronë, si më poshtë: 1 dron DJI Mini, marrë në kuadër të projektit RESEAL, me mbështetjen e UNDP-së; 2 dronë DJI Mavic3t, të siguruar nga projekti “Flood North Albania”, i financuar nga Bashkimi Europian; 1 dron DJI Enterprise, pjesë e pajisjeve të Njësisë Mobile të Komandimit të Incidentit, dhuruar nga UNDP në kuadër të projektit	
--	--	--	--	--	--

				RESEAL. Sa është procedura prokurimi për këta dronë dhe sa kanë kushtuar? Asnjë nga dronët nuk është prokuruar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Të gjithë janë siguruar si donacione në kuadër të projekteve ndërkombëtare të sipërpërmendura. Cilët janë operatorët ekonomikë që kanë furnizuar Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me dronë? Duke qenë se dronët janë dhuruar në kuadër të projekteve ndërkombëtare, AKMC nuk ka bërë furnizime të drejtpërdrejta me operatorë ekonomikë vendas apo të huaj. Furnizimi është kryer nga organizatat zbatuese të projekteve. A janë bërë testime të dronëve të kontraktuar? Po, të gjithë dronët që posedon AKMC janë testuar dhe janë në gjendje pune funksionale.	
--	--	--	--	---	--

				A ka pasur probleme me rrëzimin e dronëve? Nëse po, a janë këto raste të regjistruara? Jo. Deri në momentin e dhënies së këtij informacioni, nuk është regjistruar asnjë rast rrëzimi apo avarie për dronët që janë në posedim nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Cila është zgjidhja e gjendur për një dron të rrëzuar? Do të furnizohen sërish pa pagesë nga kontraktori, apo është përgjegjësi e Agjencisë për të siguruar të tjerë? Në mungesë të rasteve të rrëzimit, nuk është aktivizuar asnjë procedurë zëvendësimi. Nëse ndodh një dëmtim në të ardhmen, kjo do të trajtohet rast pas rasti në bashkëpunim me donatorët ose nëpërmjet mjeteve të brendshme. Ju falënderojmë për interesimin dhe mbetemi në dispozicion për çdo informacion të mëtejshëm. Me respekt		
2						

